

MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS

HIGJIENA NË SHKOLLAT DHE ÇERDHE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS NË KOHË PANDEMIE



Në tenderin “**Furnizim me materiale higjienike për institucionet arsimore**” me numër të prokurimit 616-20-1092-1-2-1 kanë marrë pjesë pesë ofertuesë. Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur**.



Për këtë tender, **Komuna e Prishtinës kishte shpallur fitues operatorin ekonomik El Shpëtimi**, kontratë kjo me vlerë prej 38,126.70 €.



Sipas kontratës, furnizimi duhet të bëhet në pothuajse të gjitha shkollat e mesme të larta, në shumicën e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe të gjitha institucionet parashkollore apo çerdhet brenda komunës.



Te një nga produktet, **komuna ka kërkuar markën Fresh, por përmendja e një brendi të caktuar është e ndaluar me Ligjin për Prokurimin Publik**. Një gjë e tillë, eliminon apo redukton konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.




Gjithashtu, **El Shpëtimi ka ofertuar çmime shumë më të lira sesa ato të tregut**. Në këso raste, problemet paraqiten te zbatimi i kontratës dhe cilësia e produkteve.




Krahasimi i çmimeve të kontratës me ato të tregut:

- Për një litër **shampon për enë**, El Shpëtimi ka ofertuar me 0.60 cent, ndërsa në treg, i njëjti produkt me të njëjtën sasi blihet për rreth 1.50 euro.
- **Sfungjerët për enë** janë ofertuar me 0.10 cent, por të njëjtit blihen në treg me çmim prej rreth 0.50 cent.
- Çmim tjetër që dallon është edhe ai i **telave për enë**. El Shpëtimi ia ka shitur Komunës së Prishtinës vetëm për 0.07 cent, ndërsa në treg gjendet me 0.30-0.40 cent.



Demokrati Plus ka vizituar dy shkolla të mesme, shkollën “Sami Frashëri” dhe “Abdyl Frashëri” dhe **është konstatuar që të njëjtat, në kohën kur është bërë hulumtimi, nuk kanë qenë të furnizuara me materialet e kontratës së re nga kompania fituese**.



REKOMANDIME

Në pajtim me të gjeturat dhe analizimin e tenderit për furnizim me materiale higjienike për institucionet arsimore, i rekomandohet Komunës së Prishtinës të bëjë:

1. Vlerësimin paraprak të nevojave lidhur me materialet higjienike.

2. Analizimin e çmimeve të tregut të të gjitha produkteve që planifikohen të blihen përmes prokurimit publik;

3. Përpilimin e specifikave në mënyrë sa më të detajuar të çdo produkti që planifikohet të blihet.

4. Vlerësimin dhe ekzaminimin e çmimeve për njësi.

5. Shmangien e kërkesave që lidhen me marka (brende) të caktuara.